

Fjala e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë z. Gramoz Ruçi:

Përshëndetje,

Të nderuar deputetë dhe deputete, anëtarë të grupit “Miqtë e Fëmijëve”

Të nderuar deputetë të pranishëm,

I nderuar z. Murzi

Të nderuar përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe të organizatave të shoqërisë civile

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj të pranishëm,

Më 17 nëntor 2018, në këtë sallë së bashku me një pjesë prej jush, Kuvendi konstituoï grupin e deputetëve “Miqtë e fëmijëve”.

Në fjalën time përshëndetëse në takimin e parë të grupit të të miturve, u ndala në disa çështje që kërkojnë më shumë vëmendje nga deputetët, grupet parlamentare dhe stafi i Kuvendit me qëllim që të mundësojnë një jetë të mirë dhe të shëndetshme për çdo fëmijë.

Nga ana tjetër, unë ftova të gjitha organizatat vendase dhe ndërkombëtare të vazhdojnë dhe të forcojnë bashkëpunimin me Kuvendin:

-) në procesin e hartimit të ligjeve më të mira;
-) në monitorimin e zbatimit të tyre;
-) në forcimit të kapaciteteve të Kuvendit në monitorimin e mbrojtjes së interesave të fëmijës; si dhe
-) në vlerësimin e rekomandimeve të institucioneve të pavarura Kushtetuese dhe të krijuara me ligj, të organizatave të të drejtave të fëmijëve, rekomandimet që adresohen në raportet e mekanizmave monitorues të të drejtave të fëmijëve.

Më vjen mirë që pas 8 javës, Kuvendi i Shqipërisë dhe UNICEF finalizuan memorandumin e bashkëpunimit institucional mes tyre me synim forcimin e rolit ligjvënës, kontrollues dhe ndërgjegjësues të Kuvendit, komisioneve të tij të përhershme dhe të nënkomisioneve parlamentare, grupeve parlamentare, përfshirë Grupin e deputeteve “Miqtë e Fëmijëve”, me qëllim çuarjen përpara të të drejtave të fëmijëve.

Si kryetar Kuvendi dhe i grupit “Miqtë e fëmijëve” do doja të theksoja angazhimin tonë se Kuvendi do të ndërmarrë dhe mbështesë nisma ligjore për të siguruar përputhshmërinë e legjislacionit shqiptar me standardet ndërkombëtare dhe ato të Këshillit të Evropës lidhur me të drejtat e fëmijës, si dhe për të përafëruar gradualisht legjislacionin shqiptar me atë të Bashkimit Evropian në fusha të tilla si:

-) mbrojtja e fëmijëve nga dhuna, abuzimi, ngacmimi,
-) diskriminimi dhe lënia pas dore,
-) drejtësia penale për të mitur,
-) qasja e fëmijëve në drejtësi,
-) arsimi, mbrojtja sociale, shëndetësia dhe
-) buxheti për të drejtat e fëmijës.

Kuvendi do të mbikëqyrë përparimin e Shqipërisë në drejtim të zbatimit të instrumentave ndërkombëtare dhe rajonale të kësaj fushe, mes:

-) instrumentave të kontrollit parlamentar;
-) shqyrtimit të raporteve të përgjithshme vjetore dhe të raporteve e veçanta të paraqitura nga institucionet e pavarura kushtetuese ose të krijuara me ligj, nga këndvështrimi i të drejtave të fëmijës,
-) do të marrë masa dhe do të sigurohet që rekomandimeve të tyre t'u jepet vëmendja e duhur,
-) si dhe të kontribuojë në rritjen e ndërgjegjësimit publik lidhur me situatën e të drejtave të fëmijës në vend etj.